



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.Shk II.nr.1029/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhoma e shkallës së dytë, me gjyqtaren Saranda Bogaj Sheremeti në çështjen përmbartimore të kreditorit Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike (KESCO) Sh.A., kundër debitorit “FSF” Sh.P.K., me seli në Fushë Kosovë, RR. “Dardania” nr.4, në Prishtinë me bazë juridike përmbartimore, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit, të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.1336/22 të datës 29.05.2023, me datë 14.02.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pathemeltë ankesa e kreditorit Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike (KESCO) Sh.A , ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.1336/22 të datës 29.05.2023, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e atakuar KPPP.nr.1336/22 të datës 29.05.2023, në dispozitiv të aktvendimit e ka pranuar si të bazuar prapësimin e debitorit “FSF” Sh.P.K., ashtu që Urdhri Përmbartimor P.nr.531/21, i lejuar më datë 01.04.2021, nga Përmbartuesi Privat Driton Govori, është shfuqizuar.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë kreditori, (*me pretendime sikur në ankesë*), me propozim, të aprovoj ankesën si të bazuar dhe të ndryshohet aktvendimi i Gjykatës

Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.1336/22 të datës 29.05.2023, apo të anulohet dhe lënda të kthehet në rivendosje.

Ankesa e kreditorit i është dorëzuar debitorit për përgjigje, mirëpo i njëjti nuk ka parashtruar përgjigje në ankesë.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbaremore si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa e kreditorit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike (KESCO) Sh.A., ka paraqitur propozimin për përmbaremore mbi bazën e dokumentit të besueshëm – ekstraktit nga librat afariste, me datë 01.04.2021, ka lejuar urdhrin për përmbaremore P.nr. 531/21, me të cilin është urdhëruar debitori që në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të urdhrit, t’ia paguaj kreditorit shumën prej EUR 1,583.90 në emër të borxhit, me kamatë prej 8% duke filluar nga dita e kalimit të afatit për pagesë e deri në pagesën definitive.

Përmbareuesi Privat Driton Govori me seli në Prishtinë, duke vepruar sipas propozimit për përmbaremore të kreditorit me urdhrin përmbaremore P.nr.531/21, i lejuar më datë 01.04.2021, e ka lejuar përmbaremoren e propozuar nga kreditori, ndërsa debitori brenda afatit ligjor ka ushtruar me të cilin e ka kundërshtuar urdhrin për lejimin e përmbaremore, me arsyetim se dokumenti mbi bazën e së cilit është lejuar urdhri nuk ka tipare të përmbaremoreshmërisë ngase i njëjti nuk është prezantuar në origjinal apo kopje të vërtetuar. Tutje, ka shtuar se dokumenti, përkatësisht ekstrakti në fjalë as nuk është pranuar nga debitori dhe as nuk mban vulë të kreditorit. Në fund, ka kërkuar nga gjykata që prapësimi të aprovohet si i bazuar ashtu që të anulohet urdhri përmbaremore, si dhe të detyrohet kreditori që t’i kompensoj të gjitha shpenzimet procedurale debitorit.

Kreditori, në përgjigje në prapësim ka theksuar se konform rregullave ligjore dhe mbi bazën e dokumentit të besueshëm ka ushtruar propozim për përmbaremore ndaj debitorit, dhe atë në përputhje me dispozitat nga neni 29 dhe 40 të LPP-së. Ndërsa, ka theksuar se prapësimi i debitorit nuk gjen

mbështetje në nenin 69, paragrafi 4 të LPP-së, dhe se debitori prapësimin e ka paraqitur vetëm me qëllim të zvarritjes së procedurës përmbartimore. Në fund, ka propozuar që urdhri përmbartimor të mbetet në fuqi.

Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit dhe përgjigjen në prapësim të kreditorit, ka nxjerrë aktvendimin e atakuar, KPPP.nr.1336/22 të datës 29.05.2023, ku në dispozitiv të aktvendimit e ka pranuar si të bazuar prapësimin e debitorit “FSF” Sh.P.K., ashtu që Urdhri Përmbartimor P.nr.531/21, i lejuar më datë 01.04.2021, nga Përmbartuesi Privat Driton Govori, është shfuqizuar.

Në arsyetim të aktvendimit të atakuar gjykata ka theksuar se propozimi për përmbartim mbi bazën e të cilit është lejuar urdhri, përmban të meta ngase në propozim nuk është treguar dokumenti origjinal apo kopje e vërtetuar mbi bazën e së cilit është iniciuar procedura përmbartimore, ashtu siç përcaktohet edhe me dispozitën nga neni 38, paragrafi 1 të LPP-së, me të cilën parashihet se propozimi për përmbartim, ndër të tjera, duhet ta përmbajë kërkesën për përmbartim në të cilën do të tregohet, dokumenti përmbartimor origjinal apo kopje e vërtetuar, apo dokumenti i besueshëm.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Komerciale – Dhoma e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbartimore kur e ka aprovuar prapësimin e debitorit, ngase edhe sipas vlerësimit të kësaj gjykate me shikimin në shkresat e lëndës qartë konstatohet se përmbartimi është lejuar në bazë të dokumentit të besueshëm – ekstraktit nga librat afariste, se lëshuar nga kreditori, i cili nuk përmban elementet që kërkohen me nenin 29 paragrafi par.3 i cili përcakton se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshme për përmbartim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*. Në anën tjetër, me nenin 37 të LPP-së parashihet se: *“Kur propozimi për përmbartim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit”* e po që se i referohemi propozimit për përmbartim të ushtruar nga ana e kreditorit, rezulton se i njëjti është bërë duke u referuar në dokumentin përmbartues, i cili nuk është dorëzuar në origjinal apo kopje të vërtetuar, siç përcakton ligji, por është dorëzuar në kopje, andaj si e tillë nuk i ka plotësuar kushtet ligjore për caktimin e përmbartimit.

Gjykata e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim në pajtim me dispozitat ligjore, prandaj përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe gjykata e shkallës së dytë, me çka mbi bazën e këtyre rrethanave dhe fakteve kësaj gjykatë i rezultoi se aktvendimi i ankimuar i nxjerrë nga gjykata e shkallës së parë është i drejtë dhe i bazuar.

Gjykata vlerësoi pretendimet e kreditorit por te njëjta mbesin te pabazuara pasi nuk ka arrit ti argumentoj me prova juridikisht te vlefshme ashtu siç kërkon neni 69.4 i LPP dhe si te tilla i refuzoj ndërsa aktvendimin e ankimuar e vërtetoj.

Përndryshe në procedurën përmbartimore bëhet realizimi direkt i mbrojtjes juridike të konstatuar në dokumentin përmbartimor i cili përmban aktin juridik me të cilin vërtetohet ekzistimi i kërkesës dhe se nga ky dokument rrjedh e drejta e organit përmbartues që sipas propozimit të kreditorit të caktoj dhe zbatoj përmbartimin.

Kompetenca e Dhomës së Shkallës së Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhoma e shkallës së dytë

KSH.SH.II.nr.1029/23, me datë 14.02.2024

Gjyqtarja,

Saranda Bogaj Sheremeti